



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot. Tiranë, \_\_. \_\_. 2015  
Nr. Dok. 201502261/2

**Lënda:** *Rekomandojmë marrjen e masave për përmirësimin e mëtejshëm të kushteve për mirërritjen e fëmijëve në Shtëpinë e Fëmijës Parashkollorë 3-6 vjeç, Shkodër.*

**Drejtuar:** **Zj. Etleva BISHA**  
**Shërbimi Social Shtetëror**  
*Drejtoreshë e Përgjithshme*

**TIRANË**

***E nderuar Znj. Bisha,***

Në përmbushje të detyrave kushtetuese dhe ligjore në mbrojtje të të drejtave njerëzore të fëmijëve, Institucioni i Avokatit të Popullit ka hartuar planin e inspektimeve dhe po vijon punën për inspektimet në Qendrat publike të përkujdesit rezidencial të të miturve në të gjithë vendin.

Në këtë kuadër kemi inspektuar edhe Shtëpinë e Fëmijës Parashkollor Shkodër. Ky inspektim u krye në mbështetje të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku parashikohet ndër të tjera se: "Avokati i Popullit ose persona të autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim apo autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në azile dhe vecanërisht në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër ku ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut".

"Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise".

Konkretisht, pas inspektimit që përfaqësues të Institucionit tonë, kanë kryer në Shtëpinë e Fëmijës Parashkollorë 3-6, Shkodër, dhe në takimin e bërë me drejtuesit e këtij institucioni, u informuam se aty trajtoheshin fëmijë nga mosha 3-6 vjeç.

Aktualisht nga 19 fëmijë rezidencialë që kishte gjithsej, 3 prej tyre ishin larguar (2 në familje biologjike dhe 1 në familje kujdestare), ndërsa pjesa tjetër ishin nga familje me probleme sociale. Ndërkohë si Qendër Ditore trajton 10 fëmijë, pra me frekuentim ditor kryesisht nga familje me probleme ekonomike e për të cilët vendoset nga pushteti vendor frekuentimi i këtij Institucioni.

Ky Institucion ka varësi nga Shërbimi Social Shtetëror, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe financohet nga buxheti i shtetit. Drejtuesja

e komanduar e qendrës na konfirmoi se ka patur edhe donacione (sidomos nga Fondacioni "Shpresë për Botën) apo dhe donatorë të tjerë.

Personeli i këtij Institucioni përbëhej nga 17 punonjës aktualisht, nga të cilët:

-1 drejtues i komanduar (Drejtorja e Shërbimit Social Shtetëror e Qarkut Shkodër) -11 veta në sektorin e Shërbimit Social, nga të cilët 1 punonjës social, 4 specialistë edukatorë (të gjithë me arsim të lartë) dhe 6 kujdestarë; 2 vende vakante ( i drejtorit dhe kujdestarit te cilët janë shkarkuar), gjithashtu mungon edhe psikologu.

Në dhomën e pritjes ishin vendosur dy kompjutera me shërbimin e internetit, të cilat u shërbenin fëmijëve edhe për procesin e përgatitjes së mësimeve.

Ngrohja e fëmijëve në këtë qendër realizohej me kondicionerë dhe nuk paraqiste problem. Kuota ditore ushqimore, për fëmijët rezidencialë ishte 3100 lekë në muaj dhe ishte e mjaftueshme.

Për shkak të mungesës të pajisjeve për rastet e emergjencave civile apo rrezikut nga zjarri, stafi nuk ishte trajnuar por, ishte në proces blerja e pajisjeve përkatëse dhe më pas do të bëhet edhe trajnimi i stafit. Ndërkohë që këtë detyrë përkohësisht e kryen roja private e institucionit.

Gjithashtu kushtet e strehimit dhe furnizimi me artikuj të dhomave të gjumit, të gatimit, etj) ishin në parametra normale.

Nga ana e Fondacionit "Shpresë për Botën" janë ndihmuar shumë dhe lidhur me punën e diferencuar me fëmijët, për organizimin e mjaft aktiviteteve dhe ditëlindjeve të fëmijëve. Gjithashtu edhe shkolla private "Pjetër Meshkalla" kryen çdo javë aktivitete për fëmijët. Standart i trajtimit të fëmijëve konsiderohej dhe aftësimi i tyre për jetën, ndaj përpiqeshin t'i aktivizonin edhe vetë fëmijët në aktivitete brenda institucionit.

Në ambientet e Institucionit ishin të afishuara të drejtat e fëmijëve, dhe ekzistonte kutia e ankimit, e cila hapej me komision. Po ashtu fëmijët vizitoheshin si dhe takoheshin rregullisht nga të afërmit, madje ata kanë kushte që edhe nënat të mund të flenë në këtë shtëpi (institucion).

Monitorimi i standarteve në kë qendër kryhej nga Shërbimi Social Shtetëror.

### ***U konstatuan këto problematika që kanë nevojë për rregullim:***

1- Institucioni ka nevojë ***për një jurist*** (qoftë edhe part time). Zgjidhja mund të ishte që për të treja Shtëpitë e fëmijës në qytetin e Shkodrës, të punësohej një jurist.

2- Mungon ***punonjësi i shërbimit dhe sanitar***, pasi të gjithë punonjësit e shërbimit ishin kujdestarë dhe edukatorë. Pra një rregullim më i mirë i duhet kryer strukturës dhe emërtesës së punonjësve në organikë.

3- Grupmoshat që jetojnë në këtë institucion rezidencial e kanë shumë të nevojshme praninë edhe ***të një infermieri (full time)***, pasi mjeku part time nuk i mbulon nevojat e 19 fëmijëve.

4- Në fillim të çdo viti Drejtorja e institucionit bënte planin e trajnimeve, por ***më tepër trajnime duhen zhvilluar për stafin***, dhe nga ana e SHSSH ku duhen orientuar lidhur me procesin e trajnimeve, sipas kërkesave të kohës dhe teknika të disiplinimit të fëmijëve për parandalimin e dhunës;

5-Nevojitet një ***rikonstruksion i tualeteve*** tek ambientet e casa-familjes, me synimin e përmirësimit të kushteve të jetesës së fëmijëve.

Avokati i Popullit gjykon se krijimi i kushteve të përshtatshme të jetës e zhvillimit të këtyre fëmijëve duhet të jetë i një rëndësie të veçantë, nisur dhe nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, kjo në funksion të garantimit të rritjes së tyre me dinjitet e në mënyrën më të mirë të mundshme, duke gëzuar plotësisht të drejtat e tyre themelore.

Në mënyrë që ky institucion i përkujdesit publik rezidencial për fëmijët të plotësojë standardet e shërbimit të përkujdesit shoqëror në Institucionet Rezidenciale, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*,

## **REKOMANDOJMË**

Marrjen e masave për rregullimin e të gjithë problematikës shqetësuese në Shtëpinë e Fëmijës Parashkollor në Shkodër.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”*.

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe në vijimësinë e bashkëpunimit në funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijëve,

**K O M I S I O N E R I**

**Ermir KAPEDANI**